

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania 'E.' Sh.p.k. nga F., kundër të paditurit – Kuvendi Komunal në Lipjan, me bazë juridike, anulim i vendimit i të paditurit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.495/2017 dt.18.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25.04.2018, mori këtë

## **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësit Kompania 'E.' sh.p.k, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.495/2017 të datës 18.01.2018.

## **A r s y e t i m**

Me aktvendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.495/2017 të datës 18.01.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit Kompania 'E.' sh.p.k, paraqitur kundër aktvendimit të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr.544/2014 dt.25.09.2017 me të cilin është hedhë poshtë padia e paditësit si e parregullt, lidhur me anulimin e vendimit e të paditurit KK Lipjan.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.495/2017 dt.18.01.2018, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor për shkak të shkeljes të drejtës materiale dhe dispozitave procedurale, me propozim që ta aprovohet kërkesa, të anulohen aktvendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.495/2017 dt.18.01.2018, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr.544/2014 dt.25.09.2017.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktvendimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtzakonshëm është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.495/2017 dt.18.01.2018 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit Kompania 'E.', paraqitur kundër aktvendimit të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.U.nr.544/2014 dt.25.09.2017 me të cilin është hedhë poshtë padia e paditësit si e parregullt lidhur me anulimin e vendimit e të paditurit- KK Lipjan.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke e shqyrtuar kërkesën e paditësit gjen se gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, dhe duke e vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, për arsye se i njehti nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore siç pretendon paditësi.

Me dispoziten e nenit 13.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) në 03/L-202 përcaktohet se konflikti administrativ mund të fillohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative të shkallës së dytë , ose (par.2) kundër aktit administrativ të nxjerr në shkallës të parë, kundër të cilit nuk është lejuar ankimi.

Po ashtu, neni 119 të LPP-së nr.04/L-42 përcakton se, nese parashtuesi i ankesës mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një paneli shqyrtues ose OSHP është në kundërshtim me faktet ose me këtë ligj, parashtuesi i ankesës mund të kërkoj nga Gjykata shqyrtimin e vendimit. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të vendimit të OSHP-së, konform nenit 117.2 të këtij Ligji.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi në parashtresën për rregullimin-precizimin e padisë ka kërkuar që të anulohet Njoftimi për dhënien e kontratës i datës .... dhe Letrës standarde për kandidatin e eliminuar të datës .... Duke iu referuar dispozitave të LKA nr.03/L-202 dhe LPP nr.04/L-42, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur në mënyrë të drejtë dhe ligjore me hedhjen poshtë të padisë. Njoftimi për dhënien e kontratës i datës .... dhe Letra standarde për kandidatin e eliminuar e datës .... janë vendime të organit administrativ të shkallës së parë kundër të cilit nuk është i lejuar ankimi. Pra, konflikti administrativ ka mundur të inicohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative të shkallës së dytë (neni 13 LKA). Në rastin konkret, konflikti administrativ ka mundur eventualisht të inicohet kundër konkluzionit të panelit shqyrtues të datës ...., mirëpo paditësi nuk e ka kontestuar të njëjtin dhe nuk e ka kërkuar anulimin e tij.

Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë gjen se pohimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm janë të pabazuara sepse ato nuk ndikojnë në vërtetimin tjetër të gjendjes faktike nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Aktvendimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Arsyetimi i aktvendimit të goditur përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se është bërë aplikimi i drejtë të drejtës materiale dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË**

ARJ.nr.35 /2018 dt. 25.04.2018.

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Përktheu: F. A.

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq